

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-41/12

**Prishtinë,
25 korrik 2013**

Në çështjen juridike të

Z. V.

Adresa . . .

Serbi

I përfaqësuar nga

B. B.

Pala ankuese

Kundër

S. I.

Adresa . . .

Prishtinë

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtar, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/18/2008 (lënda është regjistruara në AKP me numrin KPA01429) të datës 30 prill 2008, pas shqyrtimit të mbajtur me 25 korrik 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e Z. V. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/18/2008 të datës 30 prill 2008 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA01429.
- 2- Obligohet pala ankuese që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) brenda afatit prej 90 (tridhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 7 dhjetor 2007, paraqitësi i kërkesës S. I. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës, ku ka kërkuar kthimin e pronës në posedim dhe shfrytëzim. Prona e kërkuar gjendet në komunën e Prishtinës, në **adresa e pronës ...**, me sipërfaqe prej 51,60m². Kërkesa ishte regjistruar në AKP me numrin KPA01429.

Më 30 prill 2008, KKPK-ja e ka hedhë poshtë kërkesën, duke vendosur se paraqitësi i kërkesës nuk kishte paraqitur ndonjë provë që do të dëshmonte se ai e kishte drejtën pronësore për pronën kontestuese.

Më 24 Mars 2011, Z. V. kishte paraqitur ankesë lidhur me lëndët nr. KPA01429. Ai ka theksuar vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të fakteve. Në ankesën e tij ai ka potencuar se kishte marr njoftim rastësisht se ekzistonte një kontest ndërmjet paraqitësit të kërkesës S. I. dhe palës përgjegjëse në kërkesë S. S. pranë AKP-së lidhur me pronën e kërkuar. Prandaj Z. V. kërkonte të drejtat pronësore dhe të shfrytëzimit për këtë banesë.

Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë S. S. nga ana e AKP-së më 7 mars 2012. Asnjë përgjigje nuk është pranuar pas afatit prej 30 ditësh.

Më 19 prill 2012, ankesa i është dorëzuar S. I. (paraqitësit të kërkesës). Ai ka paraqitur përgjigje me 16 maj 2012, në të cilën ai thekson se Ndërmarrja Publike Banesore është pronare e apartamentit të kërkuar.

Banesa kontestuese ishte gjithashtu objekt i shqyrtimit në Komisionin për Çështje Pronësore-Banesore (KÇPB) në mes të paraqitësit të kërkesës Z. V. dhe palës përgjegjëse në kërkesë R. S.

Më 24 prill 2005, Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore ka vendosur lidhur me kërkesën nr. DS003905 të paraqitësit të kërkesës Z. V. (tanimë në cilësinë e palës ankuese), me adresë të pronës në **adresa ...** , me vendimin grupor. HPCC/D/174/2005/C, të datës 24 shkurt 2005 duke hedhur poshtë atë dhe duke ia referuar lëndën gjykatës kompetente vendore

Më 22 shtator 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktgjykimin C.nr. 1249/08 ka miratuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë. Pala përgjegjëse në kërkesë S. S. nga Prishtina është detyruar t'ia dorëzoj banesën paditësit që gjendet në **adresa ...** , në sipërfaqe prej 28 m² të liruar atë nga të gjitha sendet dhe njerëzit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Arsyetim ligjor

Ankesa është e palejueshme.

Në këtë procedurë Z. V. pa marrë parasysh ekzistencën ose mosekzistencën e ndonjë të drejte pronësore nën zotërimin e tij nuk ka interes juridik për ankimimin e vendimit të KKKPK-ës Nr. KPCC/D/R/18/2008 për sa i përket kërkesës Nr. KPA01429 për shkak se me të Komisioni ka hedhur kërkesën e S. I. Kjo do të thotë se ky vendim nuk reflekton interesin ligjor të ankuesit Z. V. I vetmi person i cili ka interes të ankimoj këtë vendim është S. I., për shkak se e drejta e tij procedurale për të paraqitur kërkesën është mohuar. Me vendimin e cekur nuk është prekur sfera ligjore e asqijt, duke përfshirë këtu edhe atë të ankuesit Z. V.

Ekzistimi i interesit ligjor është parakusht procedural absolut për lejueshmërinë e kërkesës, ankesës, etj. në procedurën civile. Kjo është artikuluar në nenin 2.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore të vitit 2008, i cili është i aplikueshëm në procedurën e ankesës para Gjykatës Supreme kundër vendimit të AKP-ës (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50). Me këtë dispozitë ligjore parashikohet që pala duhet të ketë interesin ligjor në kërkesë dhe në veprimet e tjera procedurale të cilët mund të

administrohen në procedurë. Kushti ligjor për interesin ligjor është i vlefshëm gjatë gjithë procedurës duke përfshirë edhe fazën e ankesës ashtu siç është theksuar në nenin 186.3 *po aty*, Me këtë dispozitë ligjore parashikohet gjithashtu se ankesa është e palejueshme nëse personi i cili ushtron ankesën nuk ka interes në ushtrimin e saj.

Në rast se ankuesi pretendon të drejtën e pronësisë (ashtu siç është thënë në ankesën e tij) për pronën, e cila është objekt i vendimit ankimor dhe nëse ai pretendon se ka humbur posedimin për shkak të konfliktit të armatosur 1998/1999 ka detyrim të paraqes kërkesën për riposedim para KKPK-ës në pajtim me nenin 3 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe mbernda afateve të përcaktuara me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2007/5, i amandamentuar nga i njëjti ligj.

Prandaj, ankesa e paraqitur kundër vendimit ankimor duhet të hedhet poshtë sipas dispozitës së nenit 13.3 nëparagrafi (B) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Prandaj, vlen regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e këtyre taksave nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga

ankuesi në afat prej 90 ditësh. Sipas kësaj dispozite të nenit 47.3 parashikohet në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të përcaktuar , pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda këtyre afateve ligjore, atëherë bëhet përmbarimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX ***Sylejman Nuredini, Gjyqtar***

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it